



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 24 /2018
Data: 03.01.2018

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbali nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 12.12.2017 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Bajrush Laçi (Shef i zyrës Ligjore), Kryetar të Këshillave të Fshatrave, Drejtor të Shkollave të Komunës së Hanit të Elezit, Drejtori i QKMF-së dhe Qytetar të Komunës së Hanit të Elezit.

Rufki Suma thekson:- të nderuar këshilltarë të zgjedhur të kuvendit të komunës së Hanit të Elezit mirë se keni ardhur në mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe Udhëzuesit të Ministrisë së Pushtetit Lokal, e kam ftuar mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës dhe nga ky moment shfrytëzoj rastin të përshëndes këshilltarët e zgjedhur të kuvendit të komunës që kanë fituar ulëse në kuvendin e komunës në postin e këshilltarit si rezultat i zgjedhjeve komunale të datës 22 tetor 2017. Gjithashtu shfrytëzoj rastin t'i përshëndes: përfaqësuesit e, OSB-së, qytetarët, mediat dhe të pranishmit. Ju njoftoj se sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzuesit të Ministrisë së Pushtetit Lokal, Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës mbledhjen e kuvendit të komunës e udhëheqë këshilltari më i vjetër i kuvendit, deri në zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit. Në bazë të datëlindjeve u konstatua se këshilltari më i vjetër i kuvendit është z. Mefail Suma. Ftoj z. Mefail Suma që të udhëheqë me mbledhjen e kuvendit.

Mefail Suma thekson:- për mbledhje inauguruese të kuvendit të komunës është paraparë ky rend dite:-

1. Fjalë mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të kuvendit të komunës.
2. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.
3. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës.
4. Fjalë përshëndetëse e Kryetarit të Komunës.
5. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

1. Fjalë mirëseardhëse e anëtarit më të vjetër të kuvendit të komunës.

Mefail Suma thekson:- e kam për nder si anëtarë më i vjetër i kësaj përbërje të kuvendit ta hapë këtë kuvend solemn me rastin e konstituimit të tij pas zgjedhjeve që patëm. Më lejoni që t'ju drejtohem juve dhe qytetarëve me pak fjalë para se të procedojmë me rend të ditës. Fillimisht, falënderoj elektoratin për besimin e dhënë për t'i përfaqësuar ata përgjatë këtij mandati. Përfaqësim, i cili do të jetë, i mbushur me angazhim të plotë të të gjithë neve si anëtarë të kuvendit të komunës, në ushtrimin e përgjegjësisë ligjore që kemi, dhe me përkushtim në përmbushjen e zotimeve që kemi marrë nga qytetarët, për të qenë në funksion të realizimit të kërkesave dhe interesave të tyre për një mirëqenie më të mirë dhe jetë më të dinjitetshme për ta. Do të jem këtu për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave të qytetarëve, për të shprehur vullnetin e tyre. Të bëjmë përpjekje që të realizojmë në praktikë qeverisjen për interesin e qytetarit të Hanit të Elezit, ta bëjmë të mundur të degjohet zëri i tij. Ky kuvend, shpresoj të jetë, dhe, duhet të jetë demokratik në kuptim të plotë të fjalës. Për të qenë i tillë duhet të angazhohemi të gjithë ne që ai të jetë: përfaqësues që të përfaqësojë diversitetin politik të qytetarëve. Transparent që të jetë i hapur ndaj qytetarëve për punën që bënë dhe çështjet që trajton, i hapur ndaj medieve dhe shoqërisë civile. Llogaridhënës që të japë llogari para zgjedhësve se si ne e përdorim mandatin e dhënë

nga ta dhe integritetin personal. Efikas për organizim të mirë të procedurave të parapara me statut dhe rregullore të punës në përputhje me vlerat demokratike për tu arrit një funksionim i plot i Kuvendit të Komunës. Në fund , ne , të gjithë përfaqësuesit apo anëtarët e kuvendit si organ i zgjedhur , duhet të jemi të gatshëm gjithnjë që për interesin qytetar dhe për hir të mbarëvajtjes së punimeve këtu të ndërtojmë kompromise mes interesave të kundërta me mjete demokratike të bazuara në dialog. Këto që i thash në fund do të ishte mirë që të respektohen nga kryesuesi i kuvendit , i cili do të zgjidhet pas pak, dhe uroj që jenë parime mbi të cilat do të udhëhiqet ky kuvend. Urime dhe sukses.

2. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Mefail Suma thekson:- kuorumi ekziston për mbajtjen e mbledhjes dhe para se të fillojmë me procedurën për dhënien e betimit duhet ta formojmë një komision nga anëtarët e kuvendit për verifikimin e mandateve po ashtu propozoj që i njëjti komision të kryen edhe procedurat për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës. Ftoj grupet parlamentare që t'i propozojnë emrat për anëtarë të komisionit.

Menduh Vlashi thekson:- grupi parlamentar i AAK-së për anëtar të komisionit propozon z.Nora Xhoni.

Nexhmedin Daci thekson:- grupi parlamentar i LDK-së për anëtar të komisionit propozon z.Nexhmedin Daci.

Mehmet Ballazhi thekson:- grupi parlamentar i PDK-së për anëtar të komisionit propozon z.Florim Shkreta.

Akif Shkreta thekson:- për shkak se komisioni duhet të ketë përbërë prej tre anëtarëve grupi parlamentar i VV-së nuk ka propozim për anëtarë të komisionit.

Mefail Suma thekson:- propozimet për anëtarë të komisionit i hedh në votim; rezultati i votimit ishte një zëri. Konstatohet se formohet komisioni. Ftoj komisionit që t'i kryen procedurat për verifikimin e mandateve. Komisioni verifikoi se janë në rregull mandatet e këshilltarëve të kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit. Konstatohet se u verifikua mandati i këshilltarëve të kuvendit të komunës së Hanit të Elezit. Fletbetimet u janë shpërndarë të gjithë këshilltarëve të kuvendit të komunës dhe në vazhdim nëse jeni të pajtimit shkojmë me ceremoninë e betimit të këshilltarëve të kuvendit. Me këtë rast ftojme të gjithë të pranishmit në mbledhje që në shejë respekti për betimin e këshilltarëve të ngiten në këmbë, ndërsa të gjithë këshilltarët e zgjedhur që mendojnë të marrin përsipër detyrën e këshilltarit të kuvendit ta lexojnë tekstin e betimit solemn të përcaktuar si në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Unë do ta lexoj tekstin e betimit me zë, ndërsa ju e përsërisni çdo fjalë dhe pas dhënies së betimit solemn ju njoftoj se duhet ta nënshkruani tekstin e betimit. Unë Mefail Suma betohem(ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Hanit të Elezit , në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë. Me dhënien e betimit dhe nënshkrimin të deklaratës solemn konstatohet se u inaugurua kuvendi i komunës së Hanit të Elezit si organ legjislativ i dalur nga zgjedhjet lokale të datës 22 tetor 2017. Urime të gjithë këshilltarëve të zgjedhur të kuvendit të komunës që dhanë betimin, suksese në mandatin tuaj të zgjedhur.

3. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës.

Mefail Suma thekson:- Në vazhdim ftoj kryetarin e komunës së Hanit të Elezit z. Rufki Suma që ka fituar në zgjedhjet e 22 tetorit të lexoj tekstin e betimit solemn dhe pas leximit të tekstit të betimit të nënshkruaj deklaratën solemn.

Rufki Suma thekson:- Unë Rufki Suma betohem (ose deklaroj solemnisht) që do t'i kryej detyrat e mia dhe do t'i ushtroj kompetencat e mia si kryetar i komunës së Hanit të Elezit me nder besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin, në mënyrë që t'i siguroj kushtet për një jetë të qetë për të gjithë.

Mefail Suma thekson:- me këtë rast konstatohet se kryetari i zgjedhur i komunës së Hanit të Elezit z.Rufki Suma u betua dhe i merr përsipër detyrat e përcaktuara konform rregullativave ligjore për të udhëhequr me komunën e Hanit të Elezit.

4. Fjalë përshëndetëse e Kryetarit të Komunës.

Mefail Suma thekson:- ftoj kryetarin e komunës për fjalë përshëndetëse.

Rufki Suma thekson:- të nderuar këshilltarë të kuvendit të komunës së Hanit të Elezit, të nderuar anëtarë të mandatit të kaluar të kuvendit të komunës, të nderuar përfaqësues të OSB-së , mysafir dhe pjesëmarrës të mbledhjes solemne të inaugurimit të përbërjes së re të kuvendit të komunës së Hanit të Elezit. Me datë 22 tetor qytetarët e komunës së Hanit të Elezit edhe një herë dëshmuuan kulturën e lartë politike qytetare dhe me daljen e tyre masive në zgjedhjet lokale dhe me vullnetin e tyre të lirë vendosën që bashkë me ju të nderuar këshilltarë të jemi ata që do ta përfaqësojmë komunën tonë edhe në katër vitet e ardhshme. Të nderuar pjesëmarrës më lejoni që në emrin tim dhe në emër të qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit që me respektin më të lartë falënderojmë përbërjen e kaluar të kuvendit dhe ekzekutivin për angazhimin e tyre sepse me një punë të përbashkët të të gjithëve dhe donatorëve ndërkombëtarë kemi arritur t'i realizojmë synimet tona dhe projektet të cilat ishin në interes të qytetarëve të Hanit të Elezit për katër vitet e kaluara. Andaj zotohemi se edhe më tutje do të punojmë me të gjithë faktorët relevant duke filluar nga këshilltarët e kuvendit të ri të zgjedhur me votat e popullit, institucionet vendore dhe ndërkombëtare që qytetarëve të ju krijojmë kushte më të mira për jetesë. Do të punojmë për interesin e të gjithë qytetarëve të komunës pa dallime politike me një fjalë do të jemi në shërbim të gjithë qytetarëve. Gjatë mandatit të kaluar jemi munduar që t'i realizojmë të gjitha kërkesat e qytetarëve të cilat ishin në kompetencën tonë dhe jemi munduar brenda mundësive financiare me i realizuar kërkesat e qytetarëve. Me gjithë atë ende kemi edhe punë të tjera për t'i bërë. Do të vazhdojmë me përkrahjen e kategorive të dala nga lufta e UÇK-së , rasteve sociale, sportit dhe kulturës, investim në arsim e shëndetësi. Do të mundohemi të investojmë në bujqësi qoftë me investime me mjeteve nga buxheti i komunës por edhe përmes donatorëve të ndryshëm. Në mandatin e ardhshëm katër vjeçar prioritet mbi prioritetet do të jetë zgjedhja e problemit të ujit të pijes për të gjithë qytetarët e komunës sonë. Gjatë këtij mandati do të kërkojmë vazhdimisht nga niveli qendrorë për hapjen e zyrës për regjistrimin e automjeteve, zyrës së punësimit dhe hapjen e degës së gjykatës themelore në Han të Elezit. Me një angazhim timin dhe me kontributin tuaj të përbashkët do të mundohemi të jemi në shërbimin e qytetarëve të komunës së Hanit të Elezit. Dera e zyrës sime do të jetë gjithmonë e hapur pa orar të pacaktuar pune prej mëngjesit deri në mbrëmje për të gjithë ata të cilët kanë nevojë për ndihmën tonë. Sot po marrim mbi vete shumë obligime por unë besoj që me një bashkëpunim të sinqertë do ta kryejmë me sukses misionin tonë. Këshilltarëve të zgjedhur komunal ju uroj shëndet, punë të mbar dhe suksese në realizimin e qëllimeve tona të përbashkëta në interesat e qytetarëve.

5. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Mefail Suma thekson:- Ju njoftoj se procedura për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës është e rregulluar me udhëzimin administrativ 2009/1 të Ministrisë së Pushtetit Lokal. Sipas nenit 2.2 të këtij udhëzimi secili subjekt politik , nismë qytetarësh apo kandidat i pavarur i përfaqësuar në kuvend ka të drejtë që nga radhët e anëtarëve të kuvendit të propozoj një anëtarë për kryesues të kuvendit. Për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës ju njoftoj se votimi bëhet me vota të fshehta. Për tu zgjedhur në rundin e parë të votimit kandidati duhet të merr më tepër se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të kuvendit. Nëse në rundin e parë të votimit asnjë kandidat nuk ka fituar më tepër se gjysmën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të kuvendit atëherë dy kandidatët që kanë fituar numrin më të madh të votave shkojnë në rundin e dytë të

votimit. Në rundin e dytë të votimit për kryesues kuvendi mund të zgjedhet kandidati që ka fituar më tepër se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të kuvendit . Nëse asnjëri nga dy kandidatët nuk ka fituar numrin e mjaftueshëm të votave në rundin e dytë të votimit për tu zgjedhur për kryesues të kuvendit atëherë shkohet me rundin e tretë. Në rundin e tretë të votimit kandidati i cili merr më tepër se gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në kuvend , zgjidhet kryesues i kuvendit. Me këtë rast ftoj subjektet politik që të propozojnë kandidatë e tyre për kryesues të kuvendit.

Menduh Vlasi thekson:- në emër të grupit parlamentar të AAK-së kandidat për kryesues të kuvendit propozoj z.Qamush Brava.

Nexhmedin Daci thekson:- nuk kemi kandidat për shkak se nuk kemi asnjë marrëveshje me asnjë parti politike dhe me kryetarin e komunës nuk kemi marrëveshje të koalicionit. Për hir të vërtetës kemi qenë në bisedime por nuk kemi arritur marrëveshje dhe nuk e shohim të arsyeshme që të propozojmë kandidatë.

Mehmet Ballazhi thekson:- nuk kemi kandidat për kryesues të kuvendit për shkak se nuk kemi pas bisedime dhe nuk kemi asnjë marrëveshje. Sipas informacioneve besoj që janë të rregulluara dhe nuk do t'i hymë kësaj procedura por do të votojmë siç mendojmë ne si grup parlamentarë.

Akif Shkreta thekson:- grupi parlamentar i LVV- nuk ka kandidatë për kryesues të kuvendit të komunës.

Mefail Suma thekson:- pas propozimit të kandidatit kërkoj nga komisioni që të filloj me udhëheqjen e procedurave zgjedhore. Procedurën e votimit e kryen komisioni i zgjedhur deri në dhënien e rezultateve përfundimtare. Komisioni numëroi votat dhe sipas rezultatit të votimit 9 vota janë për 4 kundër dhe 2 abstenim. Konstatoi se me këtë rezultat të votimit kryesues i kuvend zgjidhet z.Qamush Brava. Falënderoj komisionin për procedurat dhe kryesuesit të ri z.Qamush Brava. Ju falënderoj për durimin që patët për të më dëgjuar në udhëheqjen e pjesës sime të mbledhjes, ndërsa ftoj kryesuesin e zgjedhur të kuvendit z.Qamush Brava që nga ky moment të filloj me udhëheqjen e mbledhjes.

Qamush Brava thekson:- i nderuar kryetar i komunës z.Rufki Suma, të nderuar këshilltarë, përfaqësues të OSB-së, të nderuar mysafir , zonja dhe zotëri. Kam nderin që të ju drejtohem nga foltorja e kuvendit të komunës për të falënderuar për besimin e dhënë për të qenë kryesues edhe në një mandat në komunën e Hanit të Elezit . Besojë që këtë besim do ta përmbush në mënyrë të mundshme, në të mirë të qytetarit që na i ka dhënë këtë mandat të përfaqësimit të tyre në institucionin më të lartë të kuvendit të komunës. Nga kjo foltore i drejtohem qytetarit të komunës sonë që unë si kryesues do të angazhohem në adresimin e brengës dhe problemeve të tyre në kuvend. Një kohësisht ju drejtohem edhe kuvendarëve që të mbrojmë të drejtën e qytetarëve pavarësisht përkatësisë së tyre politike fetare apo kombëtare. Komuna e Hanit të Elezit është ndër komunat më të reja në Kosovë por është edhe shembull për menaxhimin e suksesshëm të parasë publike. Me ndihmën e Zotit dhe vendosmërinë tonë ky sukses nuk do të mungoj edhe në të ardhmen. Shëndet për ju dhe familjet e juaja. Ju falënderoj për pjesëmarrje në mbledhjen inauguruese dhe shihemi në mbledhjet e ardhshme.

Mbledhja përfundoi në ora 11:46.

Procesmbajtësi
Ayni Bushi

